Në 30-vjeçarën e fundit me mijëra njerëz janë bërë mjaft të pasur, një pjesë e madhe prej tyre nga ata që punojnë në sektorin financiar (banka, bursa, kompani investimesh) në New York Londër, Hong Kong apo që merren me shfrytëzimin e burimeve natyrore (naftë, gaz dhe minerale) në vende të tilla si Australia apo Azia Qendrore. Që prej krizës financiare të vitit 2008 konsulentët e investimeve janë duke i këshilluar klientët e tyre të pasur se arti është një mënyrë e mirë për të bërë sa më të larmishëm portofolin e tyre të investimeve. Në këtë kuadër arti bashkëkohor po kthehet në një objekt global për pasanikët e rinj nëpër botë.

Një ambicie e hershme e shumë prej këtyre pasanikëve të rinj është që ti bashkohen një Bordin Muzeu si anëtarë të tij (e njohur në gjuhën angleze me emrin trustee). Në Amerikë, një rregull i pashkruar është ai

Christie kanë një publicitet shumë të madh. Kjo ua bën jetën më të lehtë tregtarëve të artit që kanë nevojë të nxisin koleksionistët që për artin bashkëkohor ia vlen të harxhosh shumata të mëdha parash. P.sh. një skulpturë prej çeliku e Jeff Koons e quajtur Qeni Balon me lartësi gati 5m u riprodhua 5 herë dhe në secilin rast me ngjyra të ndryshme. Të gjithë zotëruarit e kësaj veprë janë koleksionistë të nivelit botëror të tillë si Eli Broad dhe Francois Pinault. Kur një nga skulpturat e tij me ngjyrë portokalli u shit në Nëntor

## 10 MUZETË MË POPULLORE TË ARTIT MODERN TË VIZITUARA GJATË VITIT 2012

Nr	Emrat e shteteve	Emri i Muzeut (viti kur është hapur)	Numri i vizitorëve
<b>I</b>	<b>EUROPE</b>	<b>EUROPE</b>	<b>EUROPE</b>
1.1	Angli (Londër)	Galeria Tate (2000)	5.5 milion
	Angli (Londër)	Galeria Saatchi(1985)	1.5 milion
1.2	Francë (Paris)	Qendra Pompidu(1977)	3.8 milion
1.3	Spanjë(Madrid)	Muzeu Reina Sofia(1992)	2.8 milion
1.4	Spanja( Valencia)	Instituti i Artit Modern(1989)	1.2 milion
1.5	Spanjë(Barcelonë)	Muzeu Pikaso(1963)	1 milion
<b>II.</b>	<b>AMERIKE</b>	<b>AMERIKE</b>	<b>AMERIKE</b>
2.1	SHBA( New York)	Muzeu i Artit Modern Gugenheim(1939)	1.1 milion
<b>III.</b>	<b>AZI</b>	<b>AZI</b>	<b>AZI</b>
3.1	Koreja e Jugut(Seul)	Muzeu Kombëtar i Artit Modern& Bashkëkohor(1969)	1.2 milion
3.2	Japoni	Muzeu i Artit Mori	161.2 milion

**Burimi i të dhënave:** The Art Neëspaper. - The Economist

që thotë “jep diçka ose ik nga kuzhina”; anëtarët e bordit të këtyre muzeve shpesh janë edhe donatorët më të mëdhenj. Në shkëmbim të kësaj ndihme anëtarësia e tyre në Bordin e Muzeut u ofron atyre mundësinë që të bëhen pjesë e rretheve artistike dhe i shënjon ata si koleksionistë seriozë të artit. Kjo është pjesë e një tradite të gjatë dhe të hershme: bamirësit e pasur ishin ata që nxitën fillimin e ngritjes së shumë muzeve në shekullin e XIX.

Instituti i Artit në Çikago ka 50 anëtarë bordi (trustee) dhe 49 ish anëtarë (former trustee) që tani janë anëtarë bordi të përjetshëm. Drejtori i këtij instituti z. Douglas Druick thotë se mbajtja e marrëdhënieve të ngrohta e miqësore me anëtarët e bordit i merr atij të paktën çerekun e kohës. Ai kalon me ata nëpër takime, dreka apo darka pune afërsisht 4 ditë në javë dhe së fundi shënoi një rekord kur ishte me ata nëpër aktivitetet të ndryshme për afro 14 ditë me radhë.

Por të jesh i vëmendshëm ndaj tyre shpërblehet. Kur Bordi i Institutit të Artit në Çikago vendosi që Instituti kishte nevojë për një godinë të re, që do të ishte filliali i tij për një muze të artit bashkëkohor, anëtarët e bordit (trustee) që janë njëkohësisht dhe finansuesit e institutit ranë dakord që të mbështesnin financiarisht një pjesë të mirë të vlerës prej 300 milion \$ të kostos së ndërtimit të kësaj godine. Ky muze i artit bashkëkohor të Institutit të Artit të Çikagos është hapur kohë e fundit dhe Z. Druick (që i pëlqen tu kujtojë njerëzve se instituti i tij ishte muzeu i parë në Amerikë që ekspozoi Pikason) mendon se kjo i ka inkurajuar dhuruesit e ndryshëm që të dorëzojnë dhe të japin premtimin e tyre për të dhuruar këtij muzeu deri në 300 punime duke përfshirë edhe “koleksione të rëndësishme private”, të cilat ekspozimi në muze i bën edhe më të vlefshëm.

Në njëfarë mënyre duket e kuptueshme që muzetë kërkojnë godina po aq të reja dhe bashkëkohore për të ekspozuar punimet e këtij lloji arti (artit bashkëkohor). Në Los Anxhelos, muzeu i ri i koleksionistit të njohur të veprave të artit Eli Broadit do të hapet në fund të vitit 2014 ndërkohë që Muzeu i Artit të Los Anxhelosit ka plane për t'u nënshtruar një rinovimi të madh. Në New York, Muzeu Whitneu i Artit Amerikan është duke ndërtuar një godinë të re afër parkut High Line në Manhattan, të projektuar nga arkitekti i njohur italian Renzo Piano, arkitekti i Qendrës Pompidu në Paris. Kjo do të lejojë këtij muzeu të ekspozojë tre herë më shumë vepra seç ka bërë deri tani duke përfshirë edhe koleksionin e tij të artit bashkëkohor. Nga ana tjetër Muzeu Metropolitan i Artit në New York është duke ndarë koleksionin e veprave të artit modern e bashkëkohor nga pikturat Europiane të shek XIX dhe po ndërton për të një godinë të re.

Edhe muzeu 330 vjeçar i Ashmolean në Oxford të Britanisë së Madhe, i cili është një ndër muzetë më të vjetër në Europë, është duke planifikuar që të ndërtojë një galeri të re për artin bashkëkohor. Në Korrik të vitit 2013 ai shpalli një marrëveshje partneriteti me 2 koleksionistë të njohur amerikanë Andrew dhe Christine Hall. Sir Norman Rosenthal, një kurator dhe historiani arti i pazakontë në Oxford, ka vendosur që fillimisht të paraqesë në 3 pavione të muzeut Ashmolean një pjesë nga koleksioni i Hallëve. Të dyja palët shpresojnë dhe besojnë se kjo marrëdhënie partneriteti do të jetë e ngushtë.

**Kina**

**Të çmendur pas muzeve**

**Kina është duke ndërtuar me mijëra muze të rinj, por si do ti mbushi ato ?**

Muzeu i Artit Bashkëkohor i ndërtuar me tulla të kuqe mund të gjendet përtej Pekinit në një zonë që është urbanizuar së fundmi dhe që quhet Fshati Hegezhuang. Kruga që të çon tek muzeu është e gjerë dhe e pluhurosur. Përballë godinës së re të muzeut ndodhen dy qen të shtrirë jashtë restorantit Orchard ku punëtorët kanë vendosur veglat e

tyre dhe janë duke rruftitur nga një çaj në mesditën e nxehtë. Pavarësisht vendit jo shumë premtues ku po ndërtohet muzeumi duket sikur ka qenë edhe më parë aty. Ndërtimi i tij në stillin e tullave të kuqe përzihet me shkëlqimin dhe të verdhën e shndritshme të diellit. Në brendësi të muzeut janë ambientet me ajër të kondicionuar dhe rreth 7 hapësira të ekspozimi me të gjithë dritat e ndezura. Përveç një grupi objekteve në një cep të vogël afër hyrjes, muzeu nuk ka absolutisht asgjë tjetër për të ekspozuar. Është njësoj sikur të ecësh në një pishinë olimpike që është e boshatisur.

Godina me Tulla të Kuqe e Muzeut të Artit Bashkëkohor është ndërtuar para një viti nga një biznesmen i ndërtimit Yan Zhijie nga Xingtai, një qytet i vogël 350 km në jug-perëndim të Pekinit. Ajo shëmbëllen me atë që Jeffrey Johnson, drejtor i Columbia Uni-

për të ekspozuar tani për tani. Nga ana tjetër koleksionistët e pasur kinezë janë duke krijuar muze private për të treguar pasuritë e thesareve të tyre.

Sipas planit aktual 5-vjeçar të qeverisë kineze, Kina duhet të arrijë numrin e 3,500 muzeve të ndërtuara deri në vitin 2015, por ky objektiv u arrit që në vitin 2012. Gjatë vitit 2012 në Kinë u hap një numër rekord prej 450 muzeve të reja duke e çuar numrin total në fund të vitit 2012 në 3,866 sipas An Laishun zv/president i Shoqatës Kineze të Muzeumeve. Ndërkohë që përkundër këtyre të dhënave në SHBA 10 vjet para fillimit të krikës financiare të 2008 (1998) ndërtoheshin vetëm 20-40 muze në vit.

Muzetë publike nuk kanë qenë tradicionalisht pjesë e kulturës kineze. Koleksionet e famshme perandorake dhe veçanërisht ato të perelmanit janë mbajtur në Pallatin

gojnë kulturën e vjetër kineze banorëve vendas dhe të huajve dhe flasin për rëndësinë e kujtimit të së shkuarës si dhe edukimin e brezit të ri.


Në vitin 2000 gjatë një mbledhje të qeverisë kineze, kultura u vendos të jetë në nivelin e një dege strategjike të ekonomisë. Plani aktual 5vjeçar 2011-2015 i qeverisë kineze është një dokument strategjik që përcakton me hollësi politikat qeveritare. Në këtë plan kultura është përcaktuar si “shpirti dhe fryma e kombit” dhe një forcë e fuqishme për zhvillimin e vendit. Me kalimin e kohës kultura po bëhet një “industri bazë” duke synuar të arrijë të paktën deri në 5 % të GDP së vendit. Kjo shifër është dyfishi i saj me të cilin kultura kontribuon sot në ekonominë kineze (afër 2.5 % e GDP) por parashikohet që pas një periudhe 10 vjeçare kontributi i saj të arrijë deri në 15 % të GDP. Në këtë kuadër muzeumet janë një pjesë integrale e kësaj politike dhe po shumëfishohen me shpejtësi - madje në disa raste shumë shpejt. Por ndërtimi i tyre dhe paraqitja e koleksioneve, planifikimi i ekspozitave, trajnimi i kuratorëve, restauratorëve, dhe stafit të muzeut apo programet edukative janë ende shumë prapa në raport me shpejtësinë e ndërtimit të godinave.

Në Pekin, qeveria është duke planifikuar të kthejë një pjesë të parkut olimpik, që u ndërtua për Lojërat Olimpike e vitit 2008, në një qendër kulturore me 3 muzeume të reja, një godinë opera dhe bibliotekë të re kombëtare. Një nga objektet më tërheqëse do të jetë Muzeu Kombëtar i Artit të Kinës (National Art Museum of China - NAMOC). Godina e muzeut aktual të artit kinez që ndodhet në qendër të qytetit të Pekinit ishte pjesë e një vale të hershme ndërtimesh në vitin 1958. Ajo është një godinë e lartë 5 katëshe me një hapësirë ekspozimi prej 8,300 m<sup>2</sup>, afro 1/3 e madhësisë së Qendrës Pompidu në Paris dhe ka vend ku mund të zgjerohet. Godina e NAMOC-ut të ri është afër distriktit të artit 798 në verilindje të qytetit të Pekinit, dhe do të jetë 6 herë më e madhe se muzeu aktual. Tenderi për projektin e saj e ka fituar arkitekti francez Jean Nouvel, i cili formën e godinës e ka mbështetur tek simboli grafik që ka Kina për numrin 1. Edhe drejtori i NAMOC-ut Fan Dian është përfshirë në hartimin e këtij projekti por ndërtimi ende nuk ka filluar.

NAMOC ka aktualisht në koleksionin e saj rreth 110,000 vepra arti, kryesisht të artit kinez që i përket periudhës para rënies së dinastisë kineze Qing në 1911. Ekspozatet e përhershme përfshijnë një koleksion të këtyre veprave, disa rrotulla shkrimi të dinastisë Qing dhe në katin e sipërm janë të ekspozuara rreth 100 piktura të huaja që i janë dhuruar muzeut nga koleksionisti Peter Ludwig.

Deri para pak kohësh kultura në Kinë është parë si diçka që i përket partisë, por tashmë bumbi për ndërtimin e muzeve publike ka përfshirë edhe sektorin privat. Koleksionistët e pasur duhet t'i ekspozojnë thesaret e tyre në muze të shtrenjtë. Shumë muzeume të reja në Kinë janë ndërtuar si pjesë e projekteve të mirëfillta të ndërtimit, duke shfrytëzuar muzeum si lehtësi për të marrë lejen e ndërtimit por shumë prej tyre nuk do të përdoren kurrë për qëllimin e deklaruar.

“Ne Kinezët jemi shumë të mirë për të ndërtuar hardware” na pohoi përkthyesi ynë pasi lamë një tjetër muze gjysëm-bosh gjatë vizitës tonë në Shanghai”. Të ndërtosh software është një çështje tjetër. Për botën e muzeve të Kinës, termi “software” mbulon çdo gjë që nga godina e deri tek koleksionet që do të vendosen. Ndërkohë muzetë private kanë qenë më të sukseshëm në këtë drejtim përfshirë Qendrën Ullems për Artin Bashkëkohor (Ullens Centre for Contemporary Art (UCCA) në Pekin dhe dy muze të rinj në Shangai siç është Muzeu Aurora (një burim thesaresh të periudhës së bronzit të hershëm dhe jades të designuara nga arkitekti japonez Tada Ando) dhe Muzeu i Artit Rockbund (një qendër interesante artit bashkëkohor) Më të mirët e këtyre llojeve muzeve arrijnë të kënaqin një kërkesë në rritje të publikut



Ushtarët prej terrakote, Kinë

versity China Meagcities Lab e ka përkufizuar si “museumifikimi” i Kinës: një bum i madh dhe i shpejtë ndërtimesh të muzeve që duket sikur është në garë me vetveten. Jo vetëm në Pekin e Shangai por edhe në qytetet e dorës së dytë e të tretë të Kinës po ndërtohen çdo ditë muze të ndryshëm por shumica prej tyre janë pa koleksione dhe kuratorë.

Në vitin 1949 kur Partia Komuniste e Kinës mori pushtetin Kina kishte 25 muze. Shumica e tyre u dogjën gjatë Revolucionit Kulturor në vitet 1966-1976 dhe koleksionet e tyre u zhdukën. Por rritja e shpejtë ekonomike dhe urbanizimi që shoqëroi reformat e politikave e hapjes të Ten Hnsiao Pin-it pas vitit 1978 u pasuan me një bum të ndërtimit të muzeve që bëri më shumë se sesa thjesht zëvendësoi ato që kishin humbur. Çdo kryeqytet i 34 provincave e rajoneve të Kinës është duke ndërtuar një muze të ri. Kjo duket si një mënyrë e mirë për të dhënë hov një programi kulturor megjithëse shumica e godinave nuk kanë ende asgjë

Mbretëror në Qytetin e Ndaluar të Pekinit dhe shikoheshin vetëm nga pak vetë. Në vitin 1948-1949 pas pushtimit japonez dhe shpërthimit të luftës civile, forcat rivale nacionaliste e Kuomintangut të Çai Kai Shisë ngarkuan në anije afro 230,000 objektet më të mira nga ky koleksion dhe i dërguan në ishullin e Tajvanit, ku krijuan shtetin e Tajvanit pasi komunistët morën pushtetin në Kinë. Ajo çfarë ka mbetur prej këtij koleksioni mund të shihet sot në Muzeum Kombëtar në Pekin por asnjë muze në Kinë nuk ka më përberje të tij si ato thesare që ruhen në Pallatin e Muzeut Kombëtar të Tajpejtë që është kryeqyteti i Tajvanit.

**Kultura e kultivuar**

Por zyrtarët kinezë duan ta ndryshojnë këtë gjë. Ata vlerësojnë se të gjithë qytetet e mëdha të botës New Yorku, Parisi, Londra kanë muze të rëndësishëm dhe të tillë muze duhet të ketë edhe Kina. Ata duan tu tre-

**NUMRI I MUZEVE TË NDËRTUARA NË KINË GJATË VITEVE 2000-2012**

Nr	Vitet	Rritja e Numri i muzeve sipas viteve
I	2000	2,000
	2005	2,225
	2007	2,230
	2008	2,270
	2009	2,900
	2010	3,000
	2011	3,400
	2012	3,900

Burimi i të dhënave: Shoqata Kineze e Muzeve. - The Economist

PROZA  
**P**

*Një prozë e llojit të veçantë, me të cilën publiku i "Milosao"-s është i pamësuar. Gjithsesi, po e sjellim enkas për publikum tonë, me përpjekjen e përkthyeses, për të parë mënyrën e reagimit dhe përshtatjes me këtë lloj letërsie...*

## Cili është Mathias Richard

Lindur në 1974, në Paris, jeton aktualisht në Marsejë. Shkrimtar, poet, muzikant, Mathias Richard merret me lexime-performancë të teksteve të tij, si dhe koncerte rock/elektronike, herë në emrin e tij, herë në emrin R3PLYc4N. Në 2004 bashkëkrijon platformën shumëpërmasore Caméras Animales. Në 2007 themelon mutantisme, lëvizje artistike dhe reflektimi, bashkim gjysëm-real e gjysëm-virtual. Ka publikuar librat:

«Makinë në kokë», (Vermifuge, 2013)  
«Manifesti mutantist 1.1», (Caméras Animales, 2011)  
«Anaérobiose», (Le Grand Souffle, 2009)  
«Muzikat e revoltës së mallkuar», (Caméras Animales, 2004)



### NGA MATHIAS RICHARD

**L**og in / botvituale.dll / Le ta sh katërrojmë Apokalipsin e le të mbretërojmë mbi çka mbetet. Lojë e re. / « bëhet shumë mbytëse ». Nuk jemi në krizë morale, politike, financiare, nuk gjendemi në asnjërën nga këto. Jemi në krizë zhvillimi. Po vdesim për njerëzimin, për të lindur në diçka tjetër. / Tjetërzhyendos / Kam frikë mos veshja ime e plumbtë të telefonon time më. / Provo të hysh në lidhje me Michael Jackson në kokën tënde. / Dashuria zgjat më gjatë se vdekja. / Është gjetur makina për të prodhuar kohë: Është një botë e tërë tregjesh të reja që zhvillohen: Më paguan me çeqe gjatë kohës që fle / nga një pikëpamje jo njerëzore, vetëdija njerëzore shfaqet si kancer i pakontrollueshëm. / zëmë në grackë fëmijët që vijnë në botë. / Njerëzit jetojnë në skllavëri në planetin Tokë. / Bota është një spital i madh psikiatrik. / Të gjitha psiket njerëzore formojnë një të vetme. / një psiket të vetme kolektive që ëndërron 24 orë në ditë, në një ditë pa orë e pa kufij / psikiatri e urgjencës: të mos presim që ëndrra kolektive të çlirohet. Na duhet të veprojim për veten tonë / mutantizmi është shpërthim i heshtur / zbatitëse, ëndërrroja sikur më flisje. / zgjohem. Je aty por e heshtur. / Gjenerata e dytë e vetëgjeneruar / fëmija i tretë falas / IBM riprodhon trurin e një maceje me 150.000 procesues / krijim organeve ndjesorë të sintezës / teknologjia taton produktet dhe logjikat e saj shoqërive tokësore / Ky proces i mrekullueshëm konverton oksigjenin dhe sheqerin në emocion. / ndryshime të dritës dhe ritmeve na japin nocionin e kohës dhe hapësirës / Frika i mëson elementit intelektual të ëndërrrojtë. / « Pra gjithçka është e thyer, ngado. Gjithçka është e tmerrshme, ngado, madje në qytetet rrezëllitëse amerikane, shumë të rehatshme, është e njëjta babëzi, ngado. » / Çka nuk ka qenë kurrë nuk është më përsëri. / E di, do kisha dashur të provoja përvojën e një holokausti bërthamor tek njeriu. / Në rastin e një të sapolliduri me një kaskë realiteti? / E qara e përsosur do bëhet sport i nivelit shumë të lartë. / qitje për të Ngëshur në bazë të kafkës / emergjencën e një interneti të gjithkundgjendshëm quajtur interneti i objekteve / kam një shok inspektif dhe e bën jetën shkel e shko / shtëpi-kafaz në Hong Kong / biznes sigurimi: Për ne, situata siguruese dëmtohet, më mirë s'ka. / molekulë me 46 fytyra: e gjithkundgjendshmja / majmunë ushqehen nga mendimi / e pamundshëmja për të frymëmarrë pa ekip / Një komunitet jashtëtokësor do duhej të jetojë në autonomi të plotë në një kasolle varur në një asteroid. / 100 goditje të rufeshme godasin Tokën çdo sekondë / dua të dëgjoj rrezet X, dua... / Dua të prek me tjetër gjë si këto putra të kapshme / Jam një makinë, dhe do mund të dija më shumë. / të bëhem gjetuarët që guajjnë veten / Katër kilometra gra shtatzana në të cilat

## amatemp3.2

garkullojnë protonet / kur isha i vogël, u dërgoja vizatime të burgosurve të torturuar kilianë / thonë se ndjenjat e mia për ty janë të programuara. Përpiqem t'i sjell ndërmend. Jo keq. / Boshllëk më i mirë i mundshëm duhet të mbretërojë / që të gjitha organet e të gjitha gjërave, të gjithë sytë, të gjitha gojë, të gjithë penisët, të gjitha vaginat, të gjithë veshët, të gjithë anusët, të varen mbi trupin plot me qytete të tëra të vëna në vijë, si mbi bishtin e pallojt të një bishti mbretëror dhe të kenë aty përfaqësuesit e tyre të brendshëm / t'i zëvendësojnë procedurat e ndërlikura me objekte më përmblidhëse a më të përgjithshme (punë e informatikës pa kompjuter) / namatisjet janë algoritma / algoritmat janë namatisjet për të cilat shoqëria jonë ka nevojë çdo ditë më tepër / një avion të vogël për 110 000 refugjatë! / të gjitha këto organe grumbullohen deri në festën e panairit / dhe grumbullohen përsëri / përmjet kohës e hapësirës. / « Dhe duhet ardhur castin kur vetëdija rrotullohet në një përmasë tjetër. Kjo është historia, është krizë zhvillimi. Jemi në të njëjtën pikë ku, në njëfarë çasti të zhvillimit, i është dashur të kalojë nga frymëmarrje bronkesh në frymëmarrje mushkëri, përndryshe asfiksohem. » / Baza dhe kulmi. / Lulja brenda fruitit që është njëherësh prindi dhe fëmija e tij. / Të rënë si të vjetrit. / Dera e madhe dhe ajo çka ndodh. / Mekanizma bërthamorë të aktivizuar, makina shtyn kohën në çardhakë, si makaronat e gjata në brumë të ri, dhe makina e vetme përdor kohën për të prodhuar kohë për të prodhuar kohë. / Kur makina ndalet, koha ishte një iluzion i sajuar. / Jemi të panumërt si trupat ku zotërojmë, njëherësh prindër e fëmijë pafund në kopje të përsosura. / ke njëqind njerëz të gjallë në kokën tënde / dhe je / njeriu i vetëm që njoh / Kanë fshirë mendjen e tij, kanë shpëlarë trurin e tij herë pas here, vite me radhë dhe nuk ka reshtur kurrë të së dashuri. / 1 Napollon et 1 Apollon dëgjojnë blackmetal afrikan black-metal / Do I have to upload that to your brain myself? / Log off

amatemp19 [v/m/]  
fjala më e njohur në botë është « OK »  
fjala më e njohur në botë është « OK »  
fjala më e njohur në botë është « OK » dhe e dyta është « coca cola »  
speedtalk || Mamaja ime është sisore. Si Stalini. || Jemi pederastë homofobë. || Të flas me cci. || Një çaj pa avull po dëshet. || Me ta plas shpirtin është në njëfarë mënyre gjëja më e fundit, domethënë me mrekullimin e dëshirës së ngulmët me ta plas shpirtin, qëllimi i shkatërrimit të kuptimit është arritur. || një lypës rrugësh dhe

trihet gjërë e gjatë në pistën e metrosë || Ajo lind në autostradë dhe fëmija e saj shtypet nga një makinë që zigzagon dhe provokon një përplasje të tmerrshme: 50 të vdekur. || meduzë bubblegum || europe superdroge || spam anal || Zhvillim i bujshëm || Psychic Mutant Codex || filma pa kamera || Kebabi i Prustit || spermë: dhurues universal || telash njerëzor || logo my ego || muzika ngre qimet. || si një balerinë mbi një minë antivejtakë! Ai shtrihet gjërë e gjatë duke parë qiellin. || për të shkruar njëherësh dy fjali të ndryshme me të dyja duart || për të jetuar 9 ditë me kokë të prerë, para se të vdesë nga uria. || Lilianë rrudh prapanicën në të mbrendshme prej ari. || Donald Trump thërret në revolucion. || unë guaj me plumb të bërë prej gjakut tim || Pështyma jote është kundërdhimba ime. || Çdo ditë sheh lindjen e një teknologjie që trazon mendësitë. || seks lëngues prej të paturit mbërritur kulmin e kënaqësisë || vij prej një asgjekundi pa fund e marr drejt asgjësë

Pa anglishten ju nuk ekzistoni  
Pa anglishten, nuk jeni aty  
Pa anglishten, nuk jeni as në dhomë  
Pa anglishten jeni të padukshëm  
Pa anglishten nuk mundni

Roberti bëhet Robert. || I vë zjarrin dhomës së tij të hotelit duke u munduar mos zien një lepur në një ibrik kafeje. || Adolf Hitleri ndjek tash e tutje shfaqjen tënde muzikore. || Google vdiq. || (zë ephsor) Mos do të luash në mikrovalë me mua? || Syri i saj është më i madh se truri i saj. || Fluturat shijojnë me këmbët e tyre. || Yjet e detit janë pa tru || vetëm, sytë në tavan || Avant-garda në lëvizje tek Fondacioni i Ndërmarrjes Rikard || paaftësi për të emërtuar, identifikuar e trajtuar emocionin || Gjërë që egzistojnë por nuk kanë emër. || Fjalë të mbledhura nga HP Lovecraft || mendimet tona janë burgosur në të folme: : për të modifikuar gjuhën modifiko kushtet e mendimit || për të prerë flokët me gjuhë || duke pëzier bishta zvarranikësh, sisorësh e zogjsh për të arritur tek një kafshë mozaik || një përcues i aftë për t'i thithur informacionet si sfungjer || Truri mbrohet vetë kundër ecurisë shpërbërëse të krijimit. Ngurtësohet dhe nocionet e tij të fituara forcohen në sisteme që rezistojnë po i le të shkatërrohen. || kondensim rrezesh diellore, fije nervore e spermatozoidesh || kapista të ngulura në kutinë kafkore || Idetë e bukura lindin në kryet e disiplinave. Nga kryqëzimi i kimisë me fizikën, të fizikës me mjekësinë apo të fizikës me sociologjinë. || një fetus në një meduzë || përputhje e rastësishme e të gjitha koncepteve dhe trajtimit të tyre con-

ceptual për të thyer gangsterët || fenomenet që të tjerët i kishin parë shumë më përpara, por për t'i interpretuar ndryshe || Dita e ditës || Sot... është anuluar. || izoluar nga qyteti e natyra njëherësh || të ëndërrorsh për të tejshkruar Amazonën për të mësuar një gjuhë që asnjë nuk e di || për të ndërzyer spermë njeriu te majmunit || krijesa të krijuara gjenetikiisht mbi bazën e manteleve fetare dhe termiteve me qëllimin për të shfaqur mërzi të që shndërrohen në kameleonë biomekanikë || Peshkaqenët fillojnë të shumëzohen me anën e virgjëreshave. || zogj me krahë zogjsh || Elektronet infiltrohen në secilin nga ne dhe veprojnë. || çdo ditë qëkur kam hapur sytë jam vonë || gjendet një zbraçeti e madhe brenda meje, një zbraçeti që shkatërron e bren e thith gjithçka. || Të gjithë të krisurrit telefonojnë, çmenduria shpërhapet... || disa sornambullë që bëjnë nam in gjithkund || pllenojnë dhimbjen || Është sikur zorrët të të shtrengojnë zemrën. || hajne e aparatit të zemrës || vici buldog i kapur nga shkurtabiqësia e patrajtë || gjedhe e ardhur nga një ka e një kalë duke ilustruar çiftëzimin ndërspecior || jlek i trikotuar leshi || Edhe 7 vite pa punë dhe është pensioni. || gjynah të metabolizosh perceptime shumë të pasura || rrotulloj videt në gjumë pa e marrë vesh || system i aftë për t'i shtuar fort dritëzat më të vogla lejon kështu për të ngulur shtyllat në rrethana errësimi pothuaj të plotë || përgjigje të përshatshme organizmash të nënshtruar || Zotësia individuale për tu bërë ballë forcave krijon formë kolektive.

Ky seksion është bosh, pamjaftueshmë i detajuar ose i paplotë. Ndihma juaj është e mirëpritur!

I dashur thes i vogël bollguri, lloj i bankave të spermës pema gjenetologjike e të cilave është në formë rrethi. Pederasti yt i sapollidur nuk do të flasë kurrë. || një leproz i djezur me acid më ka prekur me sytë e tij || ishin krijuar për të vdekur por shtohen. || paraja është më e rëndësishme se kuptimi || Lufta e të nesërme, çfarëdo të ndodhë na përket || gropa ime e fytyrës është vetëmbullur, po shpërthej || Mendim për mbipopullim || Ju dalloj si koloni milingonash || Ju dalloj si tub mbushur me qeliza minjsh mali të ngrira në xhelatinën nënshtruar një vandaku kundërprotonesh, pjesëzash kundërlëndë || nesër është dita e të mërziuturve, besoj të kem interes për ta fshehur makinën time! || hibridizim mes një djalit me scooter shpejtësi në fund dhe një autobuzi bashkiak || të gjithë organizmat tokësorë janë krijuar në formë L || Aparati juaj gjenital është më i fortë se një nunshaku: e dinit. || ajo është e verbër... dhe raciste || Mund të humbasësh brenda tjetrit e unë humbem të tua! || I'm a street walking cheetah with a heart full of napalm || përvoja mendore, vija vazhdon shifra, një projekt kërkimi || mësuës shpërqendrimi || nuk të ndodhë madje të imitosh veten ||

Ajo bën ende reklamën gjinsh. || bëjmë bashkë një emision porno-emocional për TF1 || roboti rikonfigurohet me një lloj vetëvëzhgimi || Mikrobet përbëjnë gjysmën e biomasës të këtij planeti. || Për të shurrur. Prandaj birra jep kaq shumë të ardhura. Nuk e blejmë, i thurim lavde vetëm. || Përtëritje me anën e shartimit të të rinjve me të vjetrit (Rejuvenation by grafting) || Po deshti Zoti.

Lexim i menjëhershëm. 100% i ligjshëm. Pa ndërprerje, as angazhim

Çliruar nga liria || çsolidarizohem plotësisht nga shfaqja e dorëshkrimit tim || krejt përçapja ime ka qëllim të krijojë shkallë të lartë shtypjeje në kokën time || sikur duhej të vdisja, kam shpenzuar krejt të hollat ; gjithmonë gjallë, jam tani në situatë financiare më shumë delikate || rekord i shpejtësisë më të shpejtë thyer nga një genie njerëzore në rënie të lirë || injektohen inde testikujsh qeni e kavieje nën lëkurë || qime bythe të mëdha si cobra || Çdo pore e lëkurës është mbyllur. || për të mos e njohur fytyrën e prindërve të saj apo fëmijëve të vet || si të zotërosh ide më të pastra || e ardhmja është bosh dhe ne gjithashtu || bazë sulmi eksperimentale e Marsejës || halucinacione të numëruara || toksimani pa drogë || organizim kaotik kamikaz || specialist emocionesh makinash || terrorist i të vërtetës || ushtrim realiteti || zgjidhja e saj është pa reshtë e përfunduar || truri i kërkon zemrë të mos harruar e dërguar më shumë gjak || një sistem fetar që ka prodhuar Manastirin Jeshil nuk mundet kurrë të vdesë || ridërguar me kohë të plotë || Në pubertet, një cunak sheh në disa javë takson e tij të testoterorit të shumëzuar me 18, përkundër 3 a 4 për vajzat. || Bota është rezultat i një ekuilibri që krijohet mes presë dhe grabitqarëve. || « Parapëlqej të qaj në sediljen e prapme të një BMW se të jem e lumtur majë një biçiklete... » || Fillon stina e dashurive : dhe aty është beteja e të gjithëve kundër të gjithëve. || realiteti i qytetëruar ndëshkimesh të shpeshta e prejardhje rrahjesh || disa fjalë janë gozhduar në trup || Sa më shumë dy qenie afrohen, aq më shumë binden se janë larguar. || numrat Flextel duke ridërguar thirrje drejt çfarëdo pike të globit || klikoni këtu për t'i dhënë fund mosdënimit || për të futur gjëndra majmuni në disa milionerë :: Testicular grafting from ape to man || Ky shqetësim diplomacie që, te disa njerëz me vështirësi përparimi, bëhet natyrë e dytë, me frikën për të zemëruar një të fuqishëm të sotëm apo të nesërm. || kristale argjile vetëjehone, që janë dorëzuar për miliarda vite luftrave para se të prodhohen nga qeliza të thjeshta || psikohistoria parathotë të ardhmen duke e konsideruar botën si një bashkësi grimcash || repertor murmurimash, frushullimash e kërcitjesh i ngathët në një nga gjuhët më të errëta të planetit || sistem që bën të prekshme çdo sipërfaqe (muri, tavoline, vitrine...) || planeti nën LSD ka dendësi të ulët përkundërt me atë të tapës dhe mund të pluskojë mbi ujë || zog me krahë :: krahë aparatësh fotografike || Njerëzit nuk më shohin kur jam përballë tyre, nuk më dëgjojnë kur u flas. || mund të më programosh në largësi ? || Shumë kanë pak kujtesë. || Problemi nuk është vetëm për t'i pasur gjërat, por për të ditur çfarë kemi. || « parapëlqej të të fyej dhe të mbetem po unë » || Ministër i Ngritjeve Prodhuese || një mut i madh mbi një tavan ! hë ? shpjegoma këtë. || Zbulon se kam kokë për ta pasur parë tashmë këtë lloj muti ??? || E zeza sipër kokës tënde, janë këto re të zeza. Në realitet, këto janë këpucë. || Tërësia e të gjitha tokave të botës është rreth 148 940 000 km2. Ti kërkon gjithmonë 10m2 e tua ! || Kurrfarë përkthimi nuk është i mundshëm për këtë përmbajtje. || Do kisha dashur shumë të mund të jeni në një mendje me mua pa qenë plotësisht të marrë.

Sollit në shqip nga frëngjishtja:  
Anila Xhekalu

## POEZA

NGA FEDERICO GARCIA LORCA\*

### VALLJA NË KOPSHTIN E PETENERËS

Në natën e kopshtit  
Gjashtë cigane kërcëjnë,  
Veshur me të bardha.

Në natën e kopshtit  
Të kurorëzuar në erë,  
Me trëndafilat letrë.

Në natën e kopshtit  
Ciganet me dhembë sedefi  
Copëtojnë hijen e djegur.

Në natën e kopështit  
Hijet e ciganeve zgjaten  
Në qiellin e manushaqet!  
\*\*\*

### VDEKJA E PETENERËS

Në shtëpinë e bardhë  
Njerëzit vdesin.

Njëqind kuaj në galop  
Kanë njëqind kalorës të vdekur!

Nën shandanët e yjeve  
Fustani i saj prej mëndafshi.

Fustani që dridhet  
Mes kofshëve prej bakri!

Njëqind kuaj në galop  
Kanë njëqind kalorës të vdekur!

Hije të mprehtë vijne  
Nga horizonti i errët.

Dhe teli bas  
I kitarës këputet.

Njëqind kuaj në galop  
Kanë njëqind kalorës të vdekur!  
\*\*\*

### FUNERALI

Ah, Petenera cigane  
Ah, Petenera?

Sa vajza të bukura  
Në funeralin tënd.

Vajza që flokët ja japin  
Krishtit të vdekur!

Me shalle të bardha  
Që nga panaiet.

Funerali yt  
Plot njerëz ogurzinj.

Njerëz  
Me zemër në kokë.

Që ecin duke qarë  
E klithur në rrugë.

Ah, Petenera cigane,  
Ah, Petenera!  
\*\*\*

### KËNGË

Nënë,  
Bëmë prej argjendi!

Bir,

Është një mrekulli kur poetin e përkthen si duhet një poet. Dhe, në këtë rast, kemi një përshtafje jo të zakonshme të Lorkës, që është dhënë përmes përkthimit cilësor të shkrimtarit Moikom Zeqo. Së fundmi, ai ka sjellë për publikun një vëllim të tërë, të kuruar prej tij, me poezitë e mjeshtrit spanjoll...



Do të mërdhish!

Nënë,  
Bëmë prej uji!

Bir,  
Do të kesh shumë ftohtë!

Nënë,  
Qëndisëm në jastëkun tënd!

Bir,  
Menjëherë, që tani!  
\*\*\*

### HESHTJA

Dëgjo heshtjen!

Një heshtje e dallgëzuar.  
Një heshtje, ku rrëshqasin  
Jehonat dhe luginat.

Dëgjo heshtjen!  
Përkule ballin  
Mbi tokë!  
\*\*\*

### AGIMI

E verbër dashuria  
Dhe këngëtarët e verbër!

Me natën jeshile rrufetë  
Lenë gjurmë të ngrohta zambaku.

Plori i Hënës çan retë  
Mbajtëset e shigjetave mbushen me vesë.

E verbër dashuria  
Dhe këngëtarët të verbër!  
\*\*\*

### CIGANIA MURGESHË

Qetësi prej gëlqereje dhe mersine,  
Ç mullaga mes gurit!

Qendis murgesha  
Mbi pëlhurën ngjyrë kashtë  
Në lampadarin gri  
Ka shtatë zogj të prizmit.  
Nga larg zgërdhiet kisha  
Si një ari  
Shtirë në shpinë!  
Sa bukur që qendis!  
Mbi pëlhurën ngjyrë kashtë.  
Murgesha do lule  
Të fantazisë së saj.  
Luledielli dhe manjola,  
Lule shafrani

Dhe shumë Hëna  
Mbi mbulesën e meshës!  
Pesë kedra  
Nxjerrin aromë në kuzhinë.  
Ja dhe pesë plagët  
E Krishtit në Almeri!  
Te sytë e murgeshës  
Lëvizin dy kalorës  
Befas një jehonë e shurdhët  
I hap murgeshës këmishën  
Gjoksi saj sheh retë  
Dhe malet në shkretëtira  
Dhe thyhet zemra e saj.  
Oh, ç luginë atje feks  
Me njëzetë Diej mbi majë!  
Çlumenj dallon  
Fantazia e saj  
Nën këmbë!  
Murgesha shikon  
Lulet  
Ndërsa drita luan  
Me gurë shahu të grilës!  
\*\*\*

### PËRLESHJA

Oh, thikat e Albaçetit  
Mes humnerës  
Shkëlqejnë si peshq!

Një dritë prej letre bixhozi  
Skicon  
Kuaj të papërmbajtshëm  
Dhe profile kalorësis!  
Mbi ulli qajnë  
Dy gra plaka.

Demi kacafytjes  
Kapërcen mbi muret.

Engjëj të zinj  
Mbahën në shamira  
Ujë dëbore!

Engjëj  
Me krahë viganë.

Nën thikat e Albaçetit  
I vdekur bije  
Huan Antonio i Montilias.

Trupi i tij plot zambakë  
Dhe shegë të çara në tëmtha!

Pastaj kalon  
Me një kryq flake  
Drejt kalvarit të vdekjes!

Një gjykatës vjen  
Me rojat e qytetit,  
Qan gjaku i derdhur  
Me këngë memecë gjarpëri!

Gjykatësi thotë:  
Këtu pati përleshje,  
Janë vrarë katër romakë  
Dhe pesë kartagjenas.

E çmendur është nata  
Prej figve  
Dhe zhurmave të nxehta.

Nata bije e zalisur  
Mbi kuajt e plagosur.

Dhe engjëjt e zinj  
Fluturojnë  
Në erën e muzgut

Ëngjëjt  
Me gërsheta të gjata  
Dhe me zemra prej vaji ulliri.

\*Përktheu Moikom Zeqo

BOTIMI

# Shqipëria e dikurshme dhe e sotme e Montanellit

NGA BEN ANDONI


**Ë**shtë afër mendjes se shumë nga vështrimet të cilat i bëri ai më shumë se shtatëdhjetë vjet përpara të mos qëndrojnë ashtu si janë thënë. Por, nga ana tjetër, nuk mund të mos thuhet se pívshtrimet e tij s'mbeten interesante. Indro Montanelli, atëherë një gazetar i ri, erdhi shumë i entuziazuar të shikonte një aneks të vendit të vet sesi po merrte udhën nën hijen e civilizimit roman. Italia e kohës së ardhjes së tij në Shqipëri është e jashtëzakonshme sa i përket ambicieve të saj ekspansioniste. Gazetari i ri nuk i shpëton tundimit ta shikojë në lëkurë vendin, të cilin e ka dëgjuar deri më atëherë thjesht në konceptin ekzotik. Nuk ka njohuri aq të mira të Shqipërisë, por duket nga shkrimi dhe konkluzionet e tij se ka pasur në dorë material jo të vogël për të. Libri është më shumë një udhëtim reportazhor mbi Shqipërinë sesa një histori e dedikuar për të. I bën më shumë përshtypje Shqipëria e Veriut dhe kullat e saj sesa fillimi i urbanizimit modern të qyteteve shqiptare. Tek e fundit e di se Shqipëria po merr vërtet fytyrën e ndërtimeve italiane, por fryma e saj gjendet ende thell brenda vetë trupit të saj. Në këtë rast mrekullohet aq shumë, saqë shpesh do të thotë se harron edhe të shënojë detaje më të imta.

Historia e vendit që paraqet është disi në dukje naive, por gjithsesi e shikon Shqipërinë në mënyrën më të përmblëdhur të mundshme duke na dhënë me këtë rast një përshkrim të historisë së vendit, që mëton se ka histori më të madhe edhe sesa vetë përandorët!

Është shumë interesant në një moment kur shprehet se gjërat që e pengojnë këtë vend janë më shumë problemet e brendshme. Të kujtohet që e sotmja është gati njësoj. "Lypset të saktësojmë se problemet më të rëndësishme të këtij shteti të ri, problemet e

vërteta, ato që kushtëzojnë jetën e tij, janë problemet e brendshme, jo të jashtmet". Mbështet planin nacionalist, të cilin e sheh si lëvizje interesante sa i përket ndarjeve, por edhe krijon idenë e një Shqipërie të bashkuar me vullnet e me dije...Por kujdes, a ka në vetvete shumë logjike? Kjo është asgjë, thotë, pasi vendit i duhet të bëjë bonifikimin (të kujtojmë se në kohën kur shkruhet ka kënetat pa fund dhe vdekje masive nga marlarja). Problemet si atëherë kur i shikon Montanelli, janë pothuaj njësoj me të sotmet, që do të thotë se fillojnë nga problemet ekonomike dhe sociale, kombëtare, e jo problemet ndërkombëtare, që dërdëllisin ata që takon në Tiranë e Shkodër: Pasi "politika e jashtme, duke mos llogaritur këtu mbrojtjen e të drejtës për pavarësi dhe përkujdesjen për prestigjin e vet, është një luks që mund t'ia lejojnë vetes vetëm kombet e pjekur, me gjendje të brendshme të konsoliduar; të afta të mbështesin kërkesat e tyre të jashtme mbi forcën e bashkuar të një vendi të shkrirë e të bërë një në të territorin e vet, me institucione të sprovuara, me ushtri, marinë, shkollë, drejtësi, me klasa shoqërore të shënuara, me një pasuri materiale dhe morale të kristalizuar", shton ai.

Interesante është ajo që përshkruan për zhvillimin e këtij vendi dhe mënyra sesi ai e shtron problemin. Etapat mund të digjen por nuk mund të kapërcehen, thotë diku. Është optimist nga të rinjtë shqiptarë, por e lodhin llafllogët e qytetit. Ndërsa në Tiranë i flasin për projekte dhe sajesa të ndërlikuara ndërkombëtare për Shqipërinë, fshtarët i flasin thjesht atë që duhet në vend. Në Tiranë, me sa duket italo-filët, i flasin për ideologjia, kufizime, sisteme, kushtetuta, por fshtarët i flasin thjesht dhe ata janë masa e këtij populli. Ata i shprehen thjesht se: "Duan që parat të të mos vidhen, që kjo tokë të kthehet nga moçalishje në tokë buke, që rruga të vijë deri këtu, që të kemi një shkollë ku të shpiem fëmijët tanë, që buka të jetë e



Shqipëria një dhe një mijë

Autori: Indro Montanelli

Gjinia: Publicistika historike

Botues: UEGEN

Përkthyes: Adrian Beshaj dhe Artan Fida

Faqe: 180

Çmimi: 600Lek

siguruar e të mos varet nga moti me shi apo me diell, që malaria të zhduket, që qetë tona të jenë më të shëndosha, që shtëpitë tona të jenë të vërteta dhe jo kasolle plot lagështirë". Ata nuk kërkojnë parti apo ideologji, duan të jetojnë shumë qetë dhe thjeshtë, thotë pak më poshtë. Kjo, sot, duket një aspiratë që i është afruar sërish vendit dhe nuk është ajo që pre-

zantohet pas matricave të vështira të zhvillimit nga politikanët, ajo përbën thjesht një kërkesë për zhvillim të zakonshëm. Shqipëria është e përcarë në tarafe për të cilat duhet bërë ujdi dhe jo shtuar parti pa fund, shton sërish.

Shqipëria, pas Luftës së Dytë Botërore, tregoi një energji të rrallë. Por Indro Montanelli spati mundësi ta shikonte më. Do të rrotullohej në andralla pa fund në Itali, kurse dalëngadalë edhe do ngjitej në një nga gazetaret më të mirë të historisë së vendit të vet. Dy të tretat e librit përfshijnë historinë e vendit por edhe problematikën e saj, që ai e plazmon përmes bisedave dhe njohjes reale të vendit në praktikë. Në pjesën e mbetur, ai na përshfaq tokën dhe ndarjen e saj, tregtinë e jashtë, pasuritë pyjore, pasuritë blegtorale, financat, qarkullimin dhe tregtimin, çështjet fetare, gjuhën, si edhe letërsinë dhe arsimin.

Libri lexohet me një frymë edhe pse duhet të themi se botimi ka kohë që është realizuar, ndërsa gjatë këtyre kohëve ka pasur edhe shumë e shumë botime të tjera të këtij lloji. Botimi i UEGEN është tepër i thjeshtë po i saktë dhe shumë për të vlerësuar. Libri përmban të vërteta të hidhura, që duke u përsëritur dhe në kohën tonë na bën të mendojmë se janë gjëra të futura thellë tek ne që nuk funksionojnë si duhet.

Indro Montanelli ka një jetë të jashtëzakonshme, e cila nisi në periudhën mes dy Luftërave Botërore. Udhëtoi shumë, por më shumë se kaq, do vlerësohet për frymën e tij të papajteshme që tregoi ngado. E quajmë me fat ardhjen e tij në Shqipëri pasi ka lënë një trashëgimi të mrekullueshme, e cila duhet vlerësuar në të gjitha aspektet e saj. Edhe pse me kufizime të arsyeshme vëzhgimet e analizat e tij duhet jo vetëm të merren në konsideratë, por shërbejnë dhe si fillës për një diagnostikim të mirë të vendit. Të dy përkthyesit kanë punuar shumë mirë dhe me kujdes. Grafiksht, libri lë shumë për të dëshiruar.

→ Vijon nga faqja 17

## ARTI BASHKËKOHOR

Përse kaq shumë muze janë duke rendur pas veprave të reja?



pati të vështirë të punësonte kuratorë me kohë të plotë. Tashmë ajo është bosh në pjesën më të madhe të kohës.

Ndërkohë dy muze të rinj e të mëdhenj të artit bashkëkohor pritet të hapen në Shanghai: njëri nga Liu Yiqian dhe nga gruaja e tij Wang Wei, njëri nga çiftet që konsiderohen si ndër koleksionistët më të mëdhenj të Shangait dhe tjetri nga Budi tek një koleksionist kinezo-indonezian i njohur për koleksionin e punimeve të Maurizio Cattelan, një skulp-

tor dhe artist italian instalacionesh. Të dy këto muze do të hapen me shumë bujë por mund të kenë vështirësi në një periudhë afatgjatë për të luajtur rolin e duhur.

Nga ana tjetër një dhimbje koke më vete gjatë hapjes së në muzeu privat në Kinë është të merresh me autoritetet kineze. Muzetë private duhet të kenë fonde të shumta si garanci për të blerë objekte ose të marrin licenca importi për të sjellë vepra arti nga jashtë goftë edhe përkohësisht. Psh. ndërsa z. Tek kishte shpresuar që të vendoste në hyrje të muzeut të tij veprën bazë të Maurizio Cattelan "Pema e Ullirit/Olive Tree", një pemë e vërtetë ulliri e mbjellë në një kub dheu, iu krijuan pengesa të shumta nga inspektorët kinezë të higjienës së bimëve (shërbimi fitosanitar knez) kur u përpoq ta importe veprën nga Spanja.

Edhe ndjeshmëria kineze ndaj temave të historisë dhe politikës kur ato përzihen me kulturën është diçka e vështirë. P.sh. ekspozitat rreth Revolucionit Kinez janë më të pëlqyeshme të zhvillohen në muzetë private sesa në ato publikë dhe parapëlqehen të jenë në muze që ndodhen larg Pekinit sesa në kryeqytet; siç u zhvilluan dy prej tyre, njëra

në Chengdu dhe tjetra në Shantou, të Kinës jugore. Edhe kur u ftohën marrëdhëniet me Japoninë, para fillimit të Bienales së Shangait në vitin 2012, pavioni i Tokios u hoq një mënyrë të prerë. Ndërkohë që në kohë të tjera artistët japonezë ekspozonin shpesh në galeritë e Pekinit.

Me artin bashkëkohor dhe ironitë e interpretimit e tij e shumëfishtë, artistët kinezë shpesh provojnë durimin e zyrtarëve. Kufijtë në këtë mes janë bërë disi të padukshëm por shumica e kinezëve e dinë sesa larg mund të shtynjë ato. Zhang Peili, drejtori i OCAT - Terminali Artit Bashkëkohor në Shanghai, një galeri private arti mjaft e mirë, ofron një listë me tema të ndaluar për artistët kinezë si psh "një ekspozitë rreth Falun Gong, Dalai Lamës apo demonstratave në sheshin Tianamen si dhe çdo që fyen liderat tanë kombëtarë ose tregon anën e tyre private"

Vijon numrin e ardhshëm

\* Përktheu nga origjinali: Aurora Kamberi (Muka), Specialiste për muzetë në Ministrinë e Kulturës. Titulli i origjinalit është Raport Special. Muzetë, 21 Dhjetor 2013